

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Kryetari i Gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar më 03.06.2024 nga avokat A.S. nga Ferizaj, me pretendimin për shkelje ligjore dhe shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj D.A., në bazë të nenit 3, 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 24.06.2024, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e datës 03.06.2024, e ushtruar nga avokat A.S. nga Ferizaj, ndaj gjyqtarit D.A., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m i

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj si autoritet kompetent, më 03.06.2024 ka pranuar ankesën e parashtruar nga avokat A.S., ankesë kjo e paraqitur kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, D.A., me pretendimin për sjellje jo etike dhe jo profesionale të shpërfaqura ndaj tij me datë 23.05.2024 në ora 10;00 në zyrën e gjyqtarit.

Parashtruesi i ankesës avokat A.S. në ankesë ka theksuar se me datë 23.05.2024 në orën 10:00 ka pasur të caktuar seancë gjyqësore dhe është paraqitur në kohën e saktë për ta njoftuar gjyqtarin se jam këtu me qëllim që të mbahet seanca. Në momentin tim të paraqitjes sjellja e gjyqtarit ka qenë jo korrekte dhe jo etike në raport me mua, ndonëse ju kam prezantuar me sinqeritet dhe e kam uruar personalisht për marrjen e postit të gjyqtarit duke shprehur kënaqësinë që do të punojmë së bashku, për faktin se i njëjti ishte dikur bashkëpunëtor profesional në këtë gjykatë dhe mes nesh ka ekzistuar një raport korrekt, mirëpo gjyqtari pati sjellje jo korrekte që nuk i takojnë as gjuhës kolegiale në mes gjyqtarit dhe avokatit. Ankuesi, ka theksuar se i është drejtuar gjyqtarit me, “z.Gjyqtarë ne kemi tani një seancë në ora 10;00” dhe ai ma ktheu, “eh avokat me nuk e kemi”. Ju drejtova pse a kërkuar dikush që të shtyhet apo çka, gjyqtari ma ktheu me gjuhë jo profesionale dhe jo etike, “o ti avokat ta kam dërguar një letër për me pagu një taksë

dhe dil jashtë se po me pengon”, avokati, thekson se ju ka drejtuar gjyqtarit, “*e çka ndodhë nëse nuk paguhet taksa*”, gjyqtari më drejtohet, “ta konsideroj të tërhequr”, dhe avokati ju drejtohet, pse nuk e ke bërë deri sot meqë sot e kemi seancën, gjyqtari më drejtohet, “e bëjmë sot dhe ta dërgojmë dhe dilum jasht nga zyrja”.

Ankuesi ka theksuar se ky debat fatkeqësisht mes meje dhe gjyqtari është zhvilluar në prezencën e avokatit nga Prishtina N.T. për të cilin unë pata përshtypjen se është avokat i palës kundërshtare duke menduar se pala kundërshtare e ka ndërruar avokatin sepse deri në atë kohë e ka pasur avokat R.Sh.

Ankuesi ka theksuar se Aktvendimi që më është konsideruar e tërhequr padia më është dorëzuar tek me datë 24.05.2024, dhe gjyqtari D.A. nuk ka pasur të drejtë që të mos e mbaj seancën e datës 23.05.2024, edhe pse në aktvendim thuhet se është marr jashtë seancës me datën 22.05.2024, mirëpo një vendim i tillë për tërheqje më është dorëzuar post festum. Nuk e kuptoj cila ka qenë arsyeja që vërejtja për taksë të më dërgohet me datën 20.03.2024 nën supozimin që afati për pagesë të ketë qenë 15 ditë, ndërkohë që seanca ishte caktuar me datë 23.05.2024, atëherë nuk kuptoj se ka mundësi që për 61 ditë nuk më është dorëzuar një aktvendim i tillë, por i njëjti të më dorëzohet vetëm një ditë pas seancës. Në rast se do të ishte dorëzuar me kohë, do të kisha pasur mundësi të hulumtoj apo të gjejë zgjidhje. Në dosjen e lëndës në fjalë unë posedoj një dokument të datës 05.09.2018 që dëshmon pagesën e një takse në vlerë prej 30 euro, por në këtë fazë nuk kam mundur ta verifikoj se a është e kësaj padie, të njëjtën e kam dorëzuar sepse konsideroj se tërheqja e padisë është bërë me gabim të gjykatës dhe gjyqtarit dhe njëherë kam lëshuar pe, mirëpo kësaj radhe do ta ndjek deri në fund shkaktarin e këtij gabimi, për arsye se pala ka udhëtuar nga Zvicra për këtë seancë dhe mos mbajtja e saj nga gjyqtari paraqet shkelje të ligjit. Ankuesi, po ashtu ka theksuar se kjo çështje ka qenë e caktuar më parë te një gjyqtar tjetër dhe çështja e shqyrtimit paraprak e padisë ka qenë çështje e konsumuar, po ashtu edhe njëherë tjetër ishte konsideruar e tërhequr për shkak të gabimit të lëshimeve të bëra nga zyra e gjyqtarit M.F., por i njëjti kishte përmirësuar gabimin e bërë nga bashkëpunëtorja e tij. Në fund ka kërkuar që të njoftohet në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesën e tij, dhe po ashtu ka deklaruar se në zyrën e tij nuk gjendet asnjë dokument i quajtur “vërejtje për pagesën e taksës” dhe këtë ka theksuar se me përgjegjësi morale, materiale dhe penale janë të vërteta.

Kryetari i Gjykatës pas pranimit të ankesës duke u mbështetur në nenin 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Nr. 05/L-057 përmes shkesës ADGJTHFR.nr.4/204 të datës 4 qershor 2024 ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës lidhur me regjistrimin e ankesës së parashtruar nga avokat A.S.

Duke u mbështetur në nenin 6 paragrafi 4 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kryetari i gjykatës si autoriteti kompetentë po me datë 4 qershor 2024 ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari ndaj të cilit është parashtruar ankesa, deklaratë të cilën më pas gjyqtari në formë të shkruar e ka bërë me datë 05.06.2024.

Gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje kontestimore D.A. në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesën avokat A.S., ka theksuar se: lëndën kontestimore C.nr.798/18, e ka pranuar me datë 14.02.2024 për të cilën më parë e ka trajtuar ish gjyqtari M.F. i cili me datë 05.01.2024 ka arritur moshën e pensionit, në të cilën çështje si palë paditëse është F.Xh. të cilin me autorizim e përfaqëson avokat A.S., kundër të paditurës “S.Sh.” sh.p.k, ti cilin me autorizim e përfaqëson avokat R.Sh., me bazë juridike mos përmbushja e kontratës. Pas pranimit të lëndës me që unë si gjyqtar i ri, sipas dispozitave ligjore të LPK-së, çështjen e pranuar duhet ta filloj nga fillimi, pas shqyrtimit paraprak të lëndës kam vërejtur se tek kjo lëndë nuk është bërë pagesa e taksës gjyqësore për padi pasi që lënda në fjalë hyn në grupin e lëndëve të vjetra dhe me qëllim të trajtimit sa më të shpejtë të kësaj çështje, kam vendosur që së bashku me ftesën për seancë datës 23.05.2024 të dërgoj edhe vërejtjes për pagesën e taksës të cilat shkresa përfaqësuesi i paditësit i ka pranuar me datë 22.03.2024, që lënda të kompletohet e të vazhdojmë me mbajtjen e seancës përgatitore për datën e planifikuar.

Për shkak të volumit të madh të lëndëve që jam ngarkuar mbi tetëqind (800), nuk kam arritur që më herët të ndërmarr veprime të përcjelli me kohë gjendjen e kësaj lënde se a është bërë pagesa e taksës gjyqësore për padi brenda afatit ligjor prej 15 ditëve, por si rregull tim të punës në kuadër të zyrës në fillim të çdo jave bëjë kontrollimin e lëndëve që i kam caktuar që të mbahen për atë javë dhe kam vërejtur se lënda në fjalë nuk i plotëson kushtet ligjore që të mbahet pasi që paditësi dhe përfaqësuesi i tij nuk ka vepruar në bazë të udhëzimeve që i ka dhënë gjykata edhe përkundër udhëzimeve se gjykata do të aplikoj dispozitat e nenit 253.5 të LPK-së, andaj pasi që paditësi dhe përfaqësuesi i tij nuk kanë vepruar sipas udhëzimeve të

gjykatës unë si gjyqtar i çështjes jashtë seancës me datë 22.05.2024, kam vendosur që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore, duke theksuar se për shkak të problemeve me sistemin SMIL vendimin nuk ka mundur ta ngarkoj dhe t'ia përcjelli palëve më herët.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, av.A.S., se unë si gjyqtar i çështjes në ditën kur ka qenë e caktuar të mbahet seanca jam sjellë dhe kam përdorur gjuhë jo profesionale dhe jo etike siç janë përshkruar në ankesë, këto pretendime nuk qëndrojnë për arsye se, fillimisht nuk janë në karakterin tim por edhe në fjalorin tim sjellja dhe përdorimi i atyre fjalëve të cilat i ka cekë avokati në ankesën e tij, dhe se e gjithë biseda me avokatin i cili fare nuk ka hyrë në zyrë, nga dera e zyrës, ka qenë fillimisht ma ka uruar marrjen e detyrës e pastaj unë i jam përgjigjur “i nderuar avokat seanca e sotme nuk mbahet pasi që më parë së bashku me ftesë ta kam dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore” dhe ju nuk keni vepruar në bazë të kësaj, i njëjti fillimisht më ka thënë se e kam paguar taksën, unë ju kam drejtuar, “të lutëm ma prezanto dëshminë e pagesës unë sot menjëherë do ta anuloj vendimin dhe do ta mbaj seancën”, i njëjti mu është përgjigjur se nuk e ka paguar taksën dhe është larguar me nxitim.

Gjyqtari ka theksuar se bazuar në nenin 107 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se “Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile, dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisive të tyre si gjyqtar”, edhe gjyqtarët në punën e tyre janë të pavarur dhe vendosin sipas provave dhe fakteve të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe sipas ligjeve në fuqi dhe rrjedhimisht gjykata, përkatësisht gjyqtari i çështjes në këtë rast por edhe në rastet tjera që ngarkohet me lëndë kanë vendosur në bazë të nenin 253.5 të LPK-së, ku shprehimisht është theksuar, “në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”. Edhe pse pretendimi i përfaqësuesit të paditësit avokatit A.S. kinse kam përdorur gjuhë jo profesionale dhe jo etike të përshkruar si në ankesë është tërësisht i pabazuar dhe i paqëndrueshëm pasi që në rastin konkret unë si gjyqtar kam vendosur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore dhe se të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në

lëndën C.nr.798/18 janë veprime të brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi si gjyqtar, në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nenin 107 par.1 dhe dispozitat ligjore të nenin 253.5 lidhur me nenin 387 par.1 pika (c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore si dhe Ligjit për Gjykatat.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese, dhe shkresave të lëndës C.nr.798/18 ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari D.A.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht gjyqtari D.A. me aktvendimin C.nr.798/18 datës 22.05.2024, ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit F.Xh., e ushtruar kundër të paditurës “S.Sh.” me seli në Ferizaj, në çështjen juridike mos përmbushja e kontratës, me arsyetimin se paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi, e që gjykata me datë 20.03.2024 paditësit – përfaqësuesit të tij me autorizim i ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore, duke njoftuar për pasojat juridike nëse nuk e bën një gjë të tillë. Po ashtu në arsyetimin e Aktvendimit të cekur më lartë është konstatuar se nga flete kthesa e datës 22.03.2024 shihet se vërejtjen për taksë pala paditëse e ka pranuar në rregull, mirëpo edhe pas kalimit të afatit të caktuar, paditësi e as përfaqësuesi i tij nuk i ka respektuar udhëzime e gjykatës dhe nuk e ka bërë pagesën e taksës, e as nuk e ka arsyetuar nëse ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagesës së taksës gjyqësore.

Autoriteti kompetent vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të avokatit A.S., se gjyqtari ka pasur sjellje jo korrekte dhe jo etike të përshkruara si në kërkesën e tij për inicim të procedurë disiplinore ndaj gjyqtarit, të ndodhur me datë 23.05.2024, në orën e paraparë për mbajtjen e seancë, ku në zyrë është paraqitur avokati A.S., pasi që i njëjti paraprakisht në bazë të ftesës për shqyrtim gjyqësor i është dërguar edhe “*vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore*”, në kuadër të së cilës avokati është njoftuar se seanca nuk do të mbahet dhe se me aktvendim padia është konsideruar e tërhequr, për çka edhe është nxjerr aktvendim nga ana e gjyqtarit, dhe nuk mund të konstatohet se gjyqtari ka pasur sjellje të tillë jo etike dhe jo korrekte, e cila do të ishte bazë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtari.

Po ashtu sa i përket pretendimit për sjellje jo profesionale nga ana e gjyqtarit të përshkruar në kërkesë e që ka të bëjë me përshkrimin e mënyrës së zbatimit të procedurës

kontestimore dhe nxjerrjes së aktvendimit, e të cilat si pretendime janë theksuar se, “gjqytari nuk ka pasur të drejtë që të mos mbajë seancën e datës 23.05.2024, dhe se aktvendimi është marrë jashtë seancës me datë 22.05.2024 dhe i është dorëzuar post festum dhe se nuk e kupton arsyen e dërgimit të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore me datë 20.03.2024 nën supozim që afati për pagesë ka qenë 15 ditë dhe se si ka mundësi që për 61 ditë nuk i është dorëzuar vendimi i tillë”, autoriteti kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk është në kompetencën, pasi që vlerësimet për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, apo konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike apo qoftë zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjyqtarit gjatë punës së tij, mund të jenë shkak apo arsye për ushtrimin e mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike në gjykatat me të larta nga pala e pakënaqur, por nuk mund të konsiderohen shkelje disiplinore nga ana gjyqtarëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Ferizaj lidhur me ankesën e parashtruar, bazuar dhe në të dhënat e përshkruara si më lartë, vlerësoi se nuk ka bazë të arsyeshme se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar kërkesë Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë në bazë të nenit 7 paragrafi 3 i Rregullores nr.05/2019, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
ADGJTHFR.nr.4/24, datë 24.06.2024

Kryetari i Gjykatës,
Mustaf Tahiri

Iu dërgohet:

Ankuesit, avokat A.S.- Ferizaj

D.A., gjyqtar

Këshillit Gjyqësor i Kosovës